

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: BUNA SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	16.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **16.05.2024**, nga Operatori Ekonomik: **BUNA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ**, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **BUNA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ**, me Numër të prokurimit: **623-24-1691-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-022-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtutjeshem për këtë aktivitetin të prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **BUNA SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, me datë: **16.05.2024** në Ora: **15:06 h**

Shih tabelën nëpërmjet sistemit te e-prokurimit:

1. Kërkesat për rishqyrtim

Data e dërgimit	Ofertuesi	Përshkrimi	Statusi kërkesës	Afati i fundit për vendim	Detajet
16.05.2024 15:06	BUNA MARKET SH.P.K.	Ankes ne njoftimin per kontrate dhe proceduren e tenderit	Paraqitur	2d 23h 48m 44s	Detajet

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Në bazë të paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së , **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.** Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit., **Në bazë të nenit të lartpërmendur Kalkulimi i afatit kohorë të kërkesës së parashtruar për ri-shqyrtim nga ana juaj fillon së numëruari nga dita e sotme.** Ndërsa në **bazë të nenit 60** paragrafi 1 pika a e Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik e cila përcakton si në vijim:

“Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se e njëjta duhet te parashtrohet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)” .

Me qenë se për Aktivitetin e Prokurimit **“RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT NË FSHATIN SAPNIQ”**, hapja e tenderëve apo data e fundit për dorëzim të ofertave është parapara data: **20.05.2024**, në Ora: **15:00 h**, **Autoriteti Kontraktues vjen në përfundim se ju si Operator Ekonomik kërkesën për ri-shqyrtim e keni parashtruar në kundërshtim me të nenit 60 paragrafi 1 pika a e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pra jashtë afatit kohore të përcaktuar me legjislacionit e prokurimit publik dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet.**

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit